



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRI I FINANCEVE

Nr 10686/1 Prot.

Tirane, me 10.11.2009

URDHËR

Nr. 94 datë 10.11.2009

**PER SHPALLJEN E STANDARDIT KOMNËTAR TË KONTABILITETIT,
NR. 15. “MBI PARIMET E KONTABILITETIT DHE RAPORTIMIT
FINANCIAR NGA MIKRONJËSITË EKONOMIKE”.**

Ne mbeshtetje te nenit 4 te Ligjit nr. 9228 date 29.04.2004 “Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” te ndryshuar, me propozim të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit,

URDHËROJ

1. Shpalljen e Standardit Kontabël Kombëtar nr. 15, “Mbi parimet e kontabilitetit dhe të raportimit financiar nga mikronjësitet ekonomike” sipas materialit bashkangjitur
2. Standardi bëhet i detyrueshëm për zbatim për pasqyrat financiare që mbulojnë periudhën kontabël nga 1 Janar i vitit 2009
3. Standardi publikohet në fletoren zyrtare, faqen e internetit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit dhe të Ministrisë së Financave
4. Ngarkohet Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit për zbatimin e urdhrin

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

Ridvan BODE